



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
IDENTITEK SHA
DIVIZIONI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Data 14.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim mirëmbajtje të UPS_ve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT CPV-50312600-1.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,642,266 (dy milion e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor IdentiTek Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik për zbatimin e kontratës duhet të ketë të punësuar në stafin e tij **jo më pak se 3 (tre) punonjës** të cilët do të kryejnë shërbimin objekt prokurimi, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Specialist Elektrik
- 1 (një) Specialist Elektronik ose Informatik

Për punonjësit e sipërcituar OE duhet të paraqese:

- Kontratë pune individuale;
- Diplomë përkatëse për Ing. Elektrik dhe Specialistin Elektronik/Informatik;
- Çertifikata kualifikimi (nëse disponojnë)
- Për punonjësin (specialist elektrik) OE duhet të paraqese edhe Dëshmi kualifikimi e Sigurimit Teknik në profilin Elektrik e lëshuar nga një institucion shtetëror ose nga një organ i akredituar.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik, për zbatimin e kontratës, të disponojë në stafin e tij jo më pak se 3 (tre) punonjës të kualifikuar, përkatësisht 1 (një) Inxhinier Elektrik, 1 (një) Specialist Elektrik dhe 1 (një) Specialist Elektronik ose Informatik, është përcaktuar në funksion të natyrës teknike të shërbimit objekt prokurimi dhe synon garantimin e realizimit të tij në mënyrë profesionale, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e procedurës. Kërkesa për Inxhinier Elektrik justifikohet nga nevoja për të siguruar praninë e një personi me formim të lartë teknik, i cili të jetë në gjendje të mbikëqyrë, koordinojë dhe verifikojë aspektet elektrike të shërbimit, përfshirë analizimin e instalimeve, furnizimit me energji, lidhjeve elektrike, parametrave teknikë dhe respektimin e kërkesave të sigurisë gjatë realizimit të punimeve. Përfshirja e një inxhinieri siguron gjithashtu kapacitetin profesional për të identifikuar dhe trajtuar problematika teknike që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për 1 (një) Specialist Elektrik është e nevojshme për realizimin praktik të ndërhyrjeve dhe punimeve elektrike që mund të kërkojnë gjatë zbatimit të kontratës. Specialisti elektrik do të angazhohet në instalime, lidhje, mirëmbajtje, kontroll dhe ndërhyrje në komponentët elektrikë, sipas nevojës dhe specifikimeve teknike të shërbimit. Për këtë pozicion kërkohet edhe Dëshmi e Kualifikimit të Sigurimit Teknik në profilin Elektrik, e lëshuar nga një institucion shtetëror ose organ i akredituar, me qëllim garantimin se punonjësi zotëron njohuritë dhe kualifikimin e nevojshëm për kryerjen e punimeve elektrike në kushte të sigurta dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë.

Ndërkohë, kërkesa për 1 (një) Specialist Elektronik ose Informatik lidhet me komponentët elektronikë dhe/ose informatikë që mund të përfshihen në shërbimin objekt prokurimi. Ky profil siguron kapacitetin profesional për instalimin, konfigurimin, testimin, diagnostikimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve elektronike ose informatike, si dhe për ndërveprimin e tyre me komponentët e tjerë të sistemit. Përcaktimi i këtyre tre profileve të ndryshme synon të sigurojë një ekip multidisiplinar, duke mbuluar në mënyrë të plotë aspektet inxhinierike, elektrike, elektronike dhe informatike të zbatimit të kontratës. Ndarja e roleve ndërmjet stafit teknik garanton që çdo komponent i shërbimit të trajtohet nga personel me kompetencat profesionale

përkatëse dhe redukton riskun e ndërprerjeve, dëmtimeve të pajisjeve apo problematikave që mund të ndikojnë në cilësinë dhe vazhdimësinë e shërbimit. Dokumentacioni i kërkuar, konkretisht kontrata individuale e punës, diploma përkatëse, certifikatat e kualifikimit, kur disponohen, si dhe dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik për specialistin elektrik, shërben për të verifikuar në mënyrë objektive disponueshmërinë dhe aftësinë profesionale të stafit të propozuar. Kërkesa për kontratë pune individuale garanton që personat e deklaruar janë realisht pjesë e strukturës së operatorit ekonomik dhe do të jenë të angazhuar në realizimin e kontratës. Në këtë mënyrë, kriteri synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetet njerëzore të nevojshme për zbatimin korrekt, të sigurt dhe cilësor të kontratës, duke garantuar njëkohësisht përgjegjshmëri profesionale dhe aftësi për reagim ndaj problematikave teknike gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Kërkesa konsiderohet e lidhur dhe proporcionale me objektin e prokurimit, pasi numri dhe profilet e personelit janë përcaktuar në funksion të nevojave konkrete teknike të shërbimit dhe jo për të kufizuar konkurrencën, por për të garantuar që operatori ekonomik që do të kontraktohet të disponojë kapacitetet profesionale minimale të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 31.08.2026; Ora: 11:00.